



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTERRI

Numri i lëndës: 2022:178741

Datë: 11.09.2024

Numri i dokumentit: 06149469

P.nr.304/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTERRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit A.M. nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprave penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 dhe Kanosja nga neni 181 par.2 dhe par.1 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1626/22 e datës 29.08.2022, e plotësuar nga prokurori i shteti në seancën e shqyrtimit fillestar me datë 09.09.2024 pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 09.09.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurorja e Shtetit Vyrtyte Gërvalla, i pandehuri A.M. dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av.B.M., më datë 09.09.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 11.09.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: A.M. nga i ati A..., e ëma XH..., e gjinisë G..., data e lindjes... nga komuna e Vushtrrisë, me vendbanim në S. në qytetin S., me numër personal..., ka të kryer shkollën e mesme, punon në fabrikën e Volvos, i martuar, prind i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i pa gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe Suedisë.

ËSHTË FAJTOR

I.SEPSE: Më datë 29.07.2022, rreth orës 11:00, në rrugën “Isa Boletini”, komuna e Vushtrrisë, i pandehuri me dashje e dëmton pasurinë e tjetrit dhe atë telefonin e të dëmtuarës S.R., ashtu që i pandehuri me dashje fillimisht e ka goditur me dorë më pas ia ka thyer telefonin të njëjtës,

- Me këtë ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së

II.SEPSE: Me datën, kohen dhe vendin si në pikën e parë të kësaj aktakuze i pandehuri me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore tani të dëmtuarës S.R., ashtu që i pandehuri ka shkuar në shtëpinë e të dëmtuarës dhe e kishte pyetur se ku ishte djali i të dëmtuarës L. e me pas e kishte goditur ne dorë duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore të konstatuar nga ekspertiza

mjekoligjore,

- Me këtë ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së

III.SEPSE: Me datën, kohën dhe vendin si në pikën e parë të kësaj aktakuze i pandehuri e kanos tani të dëmtuarën S.R., ashtu që i pandehuri ka shkuar në shtëpinë e të dëmtuarës dhe e kishte pyetur se ku ishte djali i të dëmtuarës L. e më pas e kishte goditur në dorë dhe i kishte thyer telefonin e më pas e kishte kanosur me fjalët “tjetër herë kur të vijë ka me ju vra” me çka tek e dëmtuara është shkaktuar ndjenja e frikës dhe ankthit,

- Me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.2 dhe par.1 të KPRK-së

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71, 321 par.1, 185 par.1 nën par.1.4 dhe 181 par.2 dhe par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe 462 të KPPK-së, e

G J Y K O N

Të pandehurin A.M.:

I. Për veprën e përshkruar si në pikën I të dispozitivit, të pandehurit i shqipton dënim me gjobë në shumën prej tetëqind (800) euro.

II. Për veprën e përshkruar si në pikën II të dispozitivit, të pandehurit i shqipton dënim me gjobë në shumën prej njëmijë e dyqind (1200) euro.

III. Për veprën e përshkruar si në pikën III të dispozitivit, të pandehurit i shqipton dënim me gjobë në shumën prej gjashtëqind (600) euro.

Ashtu që konform dispozitave të nenit 76 par.2, pika 2.4 te pandehurit: A.M. i shqipton DËNIM UNIK ME GJOBË në shumën prej dymijë e gjashtëqind euro (2600€), i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

Pala e dëmtuar S.R. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind euro (100€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.1626/22 e datës 29.08.2024, kundër të pandehurit A.M. nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprave penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 dhe Kanosja nga neni 181 par.2 dhe par.1 KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.1626/22 e datës 29.08.2024, kundër të pandehurit A.M. nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprave penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 dhe Kanosja nga neni 181 par.2 dhe par.1 KPRK-së, të cilën në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 09.09.2024 prokurori i shtetit e ka plotësuar në Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më datë 09.09.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklaramit rreth fajësisë, ashtu që: I pandehuri A.M. ka deklaruar se e pranon fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre dhe i premtton gjykatës që në të ardhmen kjo vepër dhe veprat e tjera nuk do të përsëritet më.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se lidhur me deklaramin e të pandehurit sa i përketë tre pikave të dispozitivit të aktakuzës i propozojmë gjykatës që te aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga ana e tij, sepse ky deklarim i tij vjen pas konsultimit të tij me mbrojtësin e tij e po ashtu gjenë mbështetje edhe në provat në bazë të cilave prokurori i shtetit e ka ngritur këtë aktakuzë.

Në raste se gjykata e aprovon pranimin e fajësisë me rastin e matjes së llojit dhe të lartësisë të dënimit të i merr si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë, pendesën e tij të shprehur lidhur me veprat që i bien në barrë, faktin se i njëjti nuk ka të kaluar kriminale pasi që nuk ka qenë i dënuar më parë ndërsa si rrethana rënduese të i mirët motivi për të cilin e ka kryer këto vepra penale e që ndërlidhet me një borxh që i njëjti pretendon që i'a ka këtu dëshmitari L..., e që si e tillë ndërthen një shkallë të lartë të dashjes në veprimet e tij. Rrethana të tjera rënduese nuk gjejmë në këtë çështje.

Mbrojtësi i të pandehurit me autorizim av. B.M. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimin të fajësisë ashtu që i propozon gjykatës që të

miratojë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij pasi që i njëjti pranim gjenë mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

I propozon gjykatës që me rastin e caktimit të dënimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të i merren një morri rrethanash posaçërisht lehtësuese si pranimi i fajësisë, ndërsa si rrethana lehtësuese të merr pendimin e shprehur nga i pandehuri, premtimin që i'a ka bërë gjykatës që të mos i përsëris më këto vepra penale, të i merret parasysh rrethanat personale pasi që i njëjti jeton në shtetin e Suedisë, kujdeset për mirëqenien e familjes së tij, ka themeluar marrëdhënie të punës, me të kuptuar për procedurën që është duke u zbatuar ka shprehur gatishmëri dhe vullnetin që të i përgjigjet gjykatës lidhur me këtë çështje penale, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, ashtu që nga të lartcekurat i propozojnë gjykatës që duke zbatuar dispozitat e nenit 71 të KPRK-së, të njëjtit të i shqiptoj një dënim unik me gjobë pasi që konsideron se ne rastin një dënim i tillë do të ishte adekuat.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2022-BD-687, i datës 29.07.2022, raporti i oficerit, i datës 29.07.2022, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin A.M., i datës 29.07.2022, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin, fotoalbumi në shtojcë prej 2 fotografive dhe raporti mjekësor i përgatitur në spitalin “Sheikh Zayed”.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprat penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 dhe Kanosja nga neni 181 par.2 dhe par.1 KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 321 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë e kryen “Kushdo që e asgjëson, dëmton apo e bën të papërdorshme pasurinë e personit tjetër në rrethana tjera nga ato të përcaktuara në nenin 322 të këtij Kodi, dënohet me gjobë ose burgim deri në një (1) vit”. Ndërsa në nenin 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së është përcaktuar se “Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në: dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. Ndërsa në nenin 181 par.2 është përcaktuar se veprën penale Kanosja e kryen “Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t'i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.” dhe në par.1 të të njëjtit nenë

është përcaktuar se “*Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t'i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkakimit të ankthit te personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.*”

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprave penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 dhe Kanosja nga neni 181 par.2 dhe par.1 KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, faktin se ka qenë i nxitur nga pala e dëmtuar përkatësisht nga djali i saj për shkak të një obligimi financiar nga djali i të dëmtuarës, si dhe se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese ka gjetur shkallën e lartë të dashjes dhe këmbëngulësinë e të pandehurit për të shkakuar tre vepra penale ndaj një femre dhe atë brenda një intervali kohor respektivisht brenda një dite.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore – juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimin lidhur me udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt civil, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: “*Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi*”.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit

36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.304/2022, datë 11.09.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.